INSTAT



SHQIPËRIA
NË SHIFRA 2025

SHQIPËRIA
NË SHIFRA
2025

SHQIPËRIA NË SHIFRA 2025

Drejtor botimi: **Dr. Lantona Sado**
© Copyright INSTAT 2026

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

INSTITUTI I STATISTIKAVE
Rr. Vllazën Huta,
Ndërtesa 35, Hyrja 1
Tiranë, Kodi Postar 1017
Tel: + 2233356 / 2222411 4 355
Fax: 411 2222 4 355+
e-mail: info@instat.gov.al
www.instat.gov.al

PËRMBAJTJA

09 POPULLSIA

11 STATISTIKAT VITALE

13 KONSUMI I NJËSIVE EKONOMIKE FAMILJARE

15 VARFËRIA RELATIVE OSE PËRJASHTIMI SOCIAL

19 TË ARDHURAT DHE PABARAZIA

21 SHËRBIMI PARËSOR

23 SHKAQET E VDEKJEVE

25 AFTËSIA E KUFIZUAR

27 VETË-PERCEPTIMI I GJENDJES SHËNDETËSORE

29 SHPENZIMET PUBLIKE NË SHËNDETËSI

31 PERSONA TË PËRFSHIRË NË SISTEMIN E DREJTËSISË

33 VEPRA PENALE KUNDËR PERSONIT

PËRMBAJTJA

35 REGJISTRIME NË ARSIM

37 DIPLOMIME NË ARSIM

39 SHPENZIMET PUBLIKE NË ARSIM

41 ARTI DHE KULTURA

43 TRASHËGIMI KULTURORE

45 SHPENZIMET PUBLIKE NË ARGËTIM, KULTURË DHE ÇËSHTJE FETARE

47 PUNËSIMI

49 PAPUNËSIA

51 ÇMIMET E KONSUMIT

53 PRODUKTI I BRENDSHËM BRUTO

57 TREGTIA E JASHTME

59 INOVACIONI

PËRMBAJTJA

63 TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT

69 BUJQËSIA (BIMËT E ARAVE)

71 BUJQËSIA (DRUFRUTORËT)

73 BLEGTORIA

75 PESHKIMI

77 MJEDISI (MBETJET URBANE DHE INERTE)

79 MJEDISI (CILËSIA E UJËRAVE LARËS NË PLAZHE)

81 SHPENZIMET PUBLIKE PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

83 PYJET

85 BIODIVERSITETI

87 TRANSPORTI

89 TURIZMI NË SHQIPËRI



01 POPULLSIA

POPULLSIA


Popullsia e Shqipërisë më 1 janar 2026 rezulton 2,34 milion banorë, duke pësuar rënie prej 1,2 % krahasuar me një vit më parë.

Gjatë vitit 2025 kanë lindur rreth 22,5 mijë foshnje, ndërsa kanë vdekur rreth 21,4 mijë persona.

Migracioni neto vazhdon të mbetet negativ (diferenca midis imigrantëve dhe emigrantëve), duke rezultuar në rreth 28,5 mijë persona të larguar, më shumë se sa të ardhur për vitin 2025.

LINDJET DHE VDEKJET

Në mijë




Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile

Më 1 janar 2026 grup-mosha 60-79 vjeç zë 25,8 % të popullsisë gjithsej, nga 24,9 % që zinte më 1 janar të vitit 2025. Tendencë në rritje shfaq edhe grup-mosha mbi 80 vjeç.

Grup-mosha 0-14 vjeç zë 14,9 % të popullsisë më 1 janar të vitit 2026, krahasuar me 15,2 % që zinte më 1 janar të vitit 2025.

POPULLSIA MË 1 JANAR SIPAS GRUP-MOSHAVE



Burimi: INSTAT

A E DINI SE?

Më 1 janar 2026, mosha mediane e popullsisë është 45,0 vjeç.

PËRKUFIZIM

Amar dhe Ajla janë emrat më popullorë për të sapolindurit gjatë vitit 2025.



02
STATISTIKAT VITALE

STATISTIKAT VITALE

Në vitin 2025 jetëgjatësia për meshkujt është 79,3 vjet dhe për femrat është 83,3 vjet.

Indeksi sintetik i fekonditetit vazhdon të jetë nën nivelin e zëvendësimit (2,1 fëmijë për grua). Në vitin 2025 numri mesatar i fëmijëve për grua ishte 1,64.

Në vitin 2025 mosha mesatare në martesë për femra është 27,6 vjeç, ndërsa mosha mesatare në martesë për meshkuj është 31,5 vjeç.

Vdekshmëria foshnjore në 2025 është 4,7 vdekje për një mijë lindje të gjalla, ndërsa vdekshmëria nën 5-vjeç është 5,7 vdekje për një mijë lindje të gjalla.

PËRKUFIZIM

Indeksi Sintetik i Fekonditetit: Numri mesatar i fëmijëve që një grua mund të lindë gjatë periudhës së saj riprodhuese 15-49 vjeç.

A E DINI SE?

Jetëgjatësia mesatare në lindje: Numri mesatar i viteve që një i lindur sot pritet të jetojë, duke marrë parasysh normat aktuale të vdekshmërisë.

TREGUES KRYESOR PËR POPULLSINË E SHQIPËRISË

	Njësia	2024	2025
Jetëgjatësia	vite	80,6	81,3
• Meshkuj	-	78,6	79,3
• Femra	-	82,5	83,3
Indeksi sintetik i fekonditetit	për grua	1,64	1,64
Mosha mesatare në martesë	vite		
• Meshkuj	-	31,4	31,5
• Femra	-	27,5	27,6
Martesat	për 1.000 banorë	6,8	6,4
Lindjet	-	9,8	9,6
Vdekjet	-	9,3	9,1
Vdekshmëria foshnjore	për 1.000 lindje	4,7	4,7
Vdekshmëria nën 5 - vjeç	-	5,6	5,7

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, INSTAT



03 KONSUMI I NJËSIVE EKONOMIKE FAMILJARE


KONSUMI I NJËSIVE EKONOMIKE FAMILJARE (NJEF)

Struktura e shpenzimeve mesatare mujore për konsum të NjEF në vitin 2024, sipas 12 grupeve kryesore të konsumit tregon se grupet "Ushqime, pije alkoolike dhe duhan" zënë peshën kryesore në buxhetin familjar me 43,8 % si në vitin 2023.

Shpenzimet e bëra në grupin "Shëndet" në vitin 2024 kanë pësuar një ulje prej 0,5 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë. Në vitin 2024, grupi "Arsim", zë 3,3 % të buxhetit të NjEF..

Grupet e shpenzimeve për banesën (energji elektrike, ujë, lëndë djegëse, qira e paguar) dhe mobilim zënë 16,4 % të totalit të buxhetit familjar.

STRUKTURA E SHPENZIMEVE TË GRUPEVE KRYESORE TË KONSUMIT (%)



Burimi: Anketa e Buxhetit të Njësive Ekonomike Familjare, 2024.

PËRKUFIZIM

Anketa e Buxhetit të Familjes është një vrojtim statistikor që kryhet pranë njësive ekonomike familjare (NjEF) dhe jep një panoramë të situatës socio-ekonomike të NjEF në Shqipëri.

NjEF i referohet një grupi personash ose një personi me lidhje gjaku ose jo të cilët banojnë së bashku në një banesë dhe që ndajnë një ekonomi pjesërisht ose plotësisht të përbashkët.

A E DINI SE?

Në vitin 2024, nëngrupet me peshën më të madhe në shpenzimet për ushqim janë:

- "perime" me 19,4 %;
- "mish dhe nënprodukte" me 18,9 %;
- "bukë dhe drithëra " me 15,4 %.




04 VARFËRIA RELATIVE OSE PËRJASHTIMI SOCIAL

VARFËRIA RELATIVE OSE PËRJASHTIMI SOCIAL

Nga Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (AANJ), Kufiri i rrezikut për të qenë i varfër për një person në vitin 2024 është vlerësuar me 324.336 lekë, në krahasim me 262.325 lekë që ishte në vitin 2023.

Treguesi i rrezikut për të qenë i varfër në Shqipëri, në vitin 2024 është 19,2 %, duke pësuar një rënie prej 0,6 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2023.

RREZIKU PËR TË QENË I VARFËR SIPAS TIPIT TË FAMILJES 2022 2023 2024 (% E INDIVIDËVE).



Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2022, 2023, 2024

**Rezultatet e anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës të vitit 2023 janë rivlerësuar bazuar në të dhënat e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023.*

***Prej vitit 2024 dhe në vijim korniza e kampionimit dhe kalibrimi i rezultateve të anketës do të bazohet në Censin e Popullsisë dhe Banesave, 2023*

A E DINI SE?

Përqindja e individëve në rrezik për të qenë të varfër sipas tipit të familjes, në vitin 2024, në familjet pa fëmijë në varësi, vlerësohet të jetë më e ulët, krahasuar me familjet me fëmijë në varësi, përkatësisht me 10,5 % dhe 24,8 % e individëve.

PËRKUFIZIM

Duke filluar nga viti 2021, treguesi i privimit material, intensiteti i ulët në punësim dhe rreziku për të qenë i varfër ose përjashtimi social (AROPE) janë modifikuar nga ana metodologjike krahasuar me strategjinë e 2020, duke u bazuar në objektivin e ri të Bashkimit Europian "Europa 2030".

Rreziku për të qenë i varfër ose përjashtimi social (AROPE), sipas agjendës Europa 2030, vlerëson përqindjen e individëve, që janë në rrezik për të qenë të varfër, ose thellësisht të privuar nga ana materiale dhe sociale, që nuk përballojnë të paktën 7 nga 13 kategori të privimit material dhe social, ose individëve të grupmoshës 18-64 vjeç që jetojnë në familje me intensitet shumë të ulët në punësim.



04 VARFËRIA RELATIVE OSE PËRJASHTIMI SOCIAL

VARFËRIA RELATIVE OSE PËRJASHTIMI SOCIAL

Shkalla e thelluar e privimit material dhe social sipas agjendës Europa 2030, paraqet përqindjen e popullsisë që nuk përballojnë të paktën 7 nga 13 kategori të privimit material dhe social. Për vitin 2024, ky tregues është vlerësuar 32,8 % kundrejt 35,9 % vlerësuar në vitin 2023.

Sipas agjendës Europa 2030, individët e grupmoshës 18-64 vjeç, të cilët jetojnë në familje me intensitet shumë të ulët në punësim në vitin 2024 sipas vlerësimeve për- bëjnë 8,4 %, kundrejt 9,7 % rezultuar në vitin 2023, duke pasqyruar një rënie prej 1,3 pikë përqindje.

Në vitin 2024 rreziku për të qënë i varfër ose përjashtimi social, sipas agjendës Europa 2030, është vlerësuar 40,5 %, kundrejt 43,2 % vlerësuar në vitin 2023.

Treguesit	2022	*2023	**2024
Kufiri i rrezikut për të qenë i varfër; familje me një person (Lekë)	225.931	262.325	324.336
Rreziku për të qenë i varfër (%)	20,6	19,8	19,2
Individët thellësisht të privuar nga ana materiale dhe sociale (%) (mungesa e 7 nga 13 kategoritë e privimit material)	37,0	35,9	32,8
Intensitet shumë i ulët në punësim (grup mosha 18-64) (%)	10,4	9,7	8,4
Rreziku për të qenë i varfër ose përjashtimi social (AROPE-Europa 2030) (%)	44,5	43,2	40,5

Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2022 , 2023, 2024

**Rezultatet e anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës të vitit 2023 janë rivlerësuar bazuar në të dhënat e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023.*

***Prej vitit 2024 dhe në vijim korniza e kampionimit dhe kalibrimi i rezultateve të anketës do të bazohet në Censin e Popullsisë dhe Banesave, 2023*

05

TË ARDHURAT DHE PABARAZIA



TË ARDHURAT DHE PABARAZIA

Nga Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (AANJ) në vitin 2024, të ardhurat mesatare mujore të disponueshme për frymë/të ekuivalentuara janë rritur me 23,2 %, krahasuar me vitin 2023.

TË ARDHURAT MESATARE MUJORE TË DISPONUESHME TË INDIVIDËVE, (NË LEKË)



Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2022 ,2023, 2024

**Rezultatet e anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës të vitit 2023 janë rivlerësuar bazuar në të dhënat e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023.*

***Prej vitit 2024 dhe në vijim korniza e kampionimit dhe kalibrimi i rezultateve të anketës do të bazohet në Censin e Popullsisë dhe Banesave, 2023*

Në vitin 2024, Koeficenti Gini është vlerësuar 29,8 %, duke pësuar rënie me 0,8 pikë përqindje nga viti 2023.

Raporti i kuintileve të të ardhurave disponibël të ekuivalentuara, S80/S20 në vitin 2024 është vlerësuar me 4,8 nga 5,0 që ishte në vitin 2023, duke paraqitur një ulje të pabarazisë.

TREGUESIT E PABARAZISË 2022, 2023, 2024

	2022	*2023	**2024
Koeficenti GINI	31,0	30,6	29,8
Raporti S80/S20	5,2	5,0	4,8

Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2022 ,2023, 2024
**Rezultatet e anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës të vitit 2023 janë rivlerësuar bazuar në të dhënat e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023.*
***Prej vitit 2024 dhe në vijim korniza e kampionimit dhe kalibrimi i rezultateve të anketës do të bazohet në Censin e Popullsisë dhe Banesave, 2023*

A E DINI SE?

Në vitin 2024 Raporti S80/20 për popullsinë 65 vjeç e lart tregon një pabarazi shumë më të vogël krahasuar me popullsinë nën 65 vjeç respektivisht në nivelet 3,5 dhe 5,0.

PËRKUFIZIM

Niveli i pabarazisë sipas shpërndarjes së të ardhurave matet nëpërmjet koeficentit Gini dhe raportit të kuintileve (kuintili i fundit me kuintilin e parë) të të ardhurave disponibël të ekuivalentuara (S80/S20).




06 SHËNDETËSIA

SHËRBIMI PARËSOR

Në vitin 2025, numri i rasteve të reja me hepatit B ka pësuar një ulje me 2,2 % krahasuar me një vit më parë. Grupmosha më e prekur nga kjo sëmundje i përket popullatës 40-59 vjeç dhe ajo më pak e prekur, popullatës 0-29 vjeç.

NUMRI I RASTEVE TË REJA ME HEPATIT B, SIPAS GRUPMOSHËS



Burimi: Instituti i Shëndetit Publik, INSTAT

Në vitin 2025, edhe pse vaksinimi brenda vitit të parë të jetës sipas skemës kombëtare të vaksinimit vazhdon të jetë i lartë, vërehet një ulje në përqindje e mbulesës vaksinale pothuajse në të gjitha llojet e vaksinave.

MBULIMI VAKSINAL (%)

Mbulimi vaksinal për	2023	2024	2025
• Tuberkulozin	99,2	99,0	99,0
• Difterinë	97,1	97,1	96,4
• Tetanosin	97,1	97,1	96,4
• Kollën e mirë	97,1	97,1	96,4
• Hepatitin B	99,2	99,3	99,0
• Haemophilus influenzae	97,1	97,1	96,4
• Poliomielitin	97,1	97,1	96,4
• Pneumokokun	85,5	81,3	81,0
• Fruthin	93,0	92,0	87,7
• Rubeolën	93,0	92,0	87,7
• Parotitin	93,0	92,0	87,7

Burimi: Instituti i Shëndetit Publik, INSTAT

PËRKUFIZIM

Shëndeti publik është përkufizuar si **"shkenca dhe arti i parandalimit të sëmundjes"**, zgjatja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës përmes përpjekjeve të organizuara dhe zgjedhjeve të informuara të shoqërisë, organizatave, publike dhe private, komuniteteve dhe individëve.

A E DINI SE?

A e dini se per vitin 2025 : 42% e vizitave mjekësore janë bërë në qendrat shëndetësore, 24% në ambulanca dhe 34% në poliklinikat e specialiteteve.

07

SHËNDETËSIA




SHKAQET E VDEKJEVE

Numri i vdekjeve të regjistruara në Shqipëri gjatë vitit 2025 është 21.394, duke shënuar një rënie prej 3,2 %, krahasuar me vitin e kaluar. Referuar shkakut kryesor të vdekjeve, 96,7 % e vdekjeve kanë ndodhur si pasojë e shkaqeve natyrale.

Grup-sëmundjet që zënë peshën më të madhe në strukturën e vdekjeve gjatë vitit 2025 janë "Sëmundjet e aparatit të qarkullimit të gjakut" (52,9 %), grup-sëmundja "Simptoma, shenja dhe sëmundje të papërcaktuara mirë" (20,9 %) dhe "Tumoret" (15,3 %).

Sipas gjinisë, sëmundjet e aparatit të qarkullimit të gjakut mbeten shkaku kryesor i vdekjeve si te femrat ashtu edhe te meshkujt, duke përbërë përkatësisht 54,5 % dhe 51,6 % të vdekjeve. Grup-sëmundja "Simptoma, shenja dhe sëmundje të papërcaktuara mirë" përbën shkakun e dytë kryesor për të dyja gjinitë, me një përqindje më të lartë te femrat (24,6 %) krahasuar me meshkujt (17,7 %). Ndërsa tumoret renditen si shkaku i tretë kryesor i vdekjeve, me një përqindje më të lartë te meshkujt (17,5 %) sesa te femrat (12,8 %).

GRUP-SËMUNDJET KRYESORE TË VDEKJEVE SIPAS GJINISË, 2025



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, INSTAT

Në vitin 2025, norma e vdekshmërisë foshnjore është 4,7 për 1.000 lindje të gjalla, duke mbetur e pandryshuar, krahasuar me vitin 2024.

Shkaqet kryesore të vdekshmërisë foshnjore janë "Sëmundjet që shfaqen në periudhën rreth lindjes", të cilat përbëjnë 43,4 % të vdekjeve foshnjore, ndjekur nga grup-sëmundja "Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut" me 25,5 % dhe grup-sëmundja "Sëmundje të aparatit të frymëmarrjes" me 11,3 % të vdekjeve të regjistruara.

A E DINI SE?

Pleqëria (senilitet) përbën shkakun kryesor të vdekjeve brenda grup-sëmundjes "Simptoma, shenja dhe sëmundje të papërcaktuara mirë", duke zënë 72,9 % të vdekjeve të regjistruara.

PËRKUFIZIM

Shkaku i vdekjes është sëmundja ose simptoma që ka shkaktuar ose kontribuar në vdekje, si dhe rrethanat e aksidentit që kanë shkaktuar këto trauma (Përshkruhet në certifikatën e vdekjes).




08

SHËNDETËSIA

AFTËSIA E KUFIZUAR

Personat me aftësi të kufizuar janë pjesë e përfituesve në skemat e Mbrojtjes Sociale. Në vitin 2025, nga totali i personave me aftësi të kufizuar, 13,3 % i përkasin grup-moshës 0-18 vjeç.

FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUAR SIPAS GRUP-MOSHAVE




Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, INSTAT

Në vitin 2025, nga totali i fëmijëve të grup-moshës 0-18 vjeç me aftësi të kufizuar, 58,4 % ndjekin shkollën sipas niveleve përkatëse arsimore. Përqindja më e madhe e fëmijëve me aftësi të kufizuar është tek ata me arsim 9 vjeçar, pasi dhe numri më i madh i tyre i përket grup-moshës 6-14 vjeç.

A E DINI SE?

Rreth 52,2 % e fëmijëve me aftësi të kufizuar i përkasin grupmoshës 6-14 vjeç.

FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUAR QË NDJEKIN SHKOLLËN, SIPAS NIVELEVE



Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, INSTAT

Për një kategori të caktuar të personave me aftësi të kufizuar ofrohen shërbime të përkujdesit specifik, në qendra publike dhe jo-publike. Në vitin 2025, numri mesatar i personave që marrin shërbimet e përkujdesit në qëndra rezidenciale dhe ditore është 3.005.

PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË QENDRAT PËR SHËRBIMET E PËRKUJDESIT

Emërtimi	2021	2022	2023	2024	2025
Numri i individëve	2.416	2.503	2.902	3.013	3.005
• Në qendra publike	1.261	1.342	1.524	1.685	1.704
• Në qendra jo-publike	1.155	1.161	1.378	1.328	1.301

Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, INSTAT

PËRKUFIZIM

Aftësia e kufizuar i referohet kufizimeve afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose shqisore, të cilat, në ndërveprim me pengesa të ndryshme, mund të kufizojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të individit në shoqëri në kushte të barabarta me të tjerët.




09 SHËNDETËSIA

VETË-PERCEPTIMI I GJENDJES SË PËRGJITHSHME SHËNDETËSORE

Në vitin 2024, 84,2 % e individëve 16 vjeç e lart kanë deklaruar se gjendja e tyre shëndetësore ka qenë shumë mirë ose mirë kundrejt 82,1 % që ishte në vitin 2023.

VETË PERCEPTIMI I GJENDJES SË PËRGJITHSHME SHËNDETËSORE PËR INDIVIDËT 16 VJEÇ E LART 2022, 2023, 2024



Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2022, 2023, 2024
**Rezultatet e anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës të vitit 2023 janë rivlerësuar bazuar në të dhënat e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023.*
***Prej vitit 2024 dhe në vijim korniza e kampionimit dhe kalibrimi i rezultateve të anketës do të bazohet në Censin e Popullsisë dhe Banesave, 2023*

Nevojat e paplotësuara për ekzaminim ose trajtim mjekësor ose dentar lidhen me një sërë arsyesh ku mund të përmenden mos përballimi financiar i shërbimit, pritja në listë, mungesa e kohës për shkak të punës, largësia ose mungesa e transportit, në pritje se mos kalon vetë problemi i tyre shëndetësor, etj.

Në vitin 2024, 16,2 % e individëve 16 vjeç e lart kanë raportuar se kanë nevojë të paplotësuar për ekzaminim ose trajtim dentar, krahasuar me 17,9 % që ishte në vitin 2023.

PËRQINDJA E INDIVIDËVE 16 VJEÇ E LART QË KANË PATUR NEVOJA TË PAPLOTËSUARA PËR KUJDES MJEKËSOR DHE DENTAR 2022, 2023, 2024

Përqindja e individëve 16 vjeç e lart për:	2022	*2023	**2024
Nevoja të paplotësuara për ekzaminim ose trajtim mjekësor	15,2	15,7	14,9
Nevoja të paplotësuara për ekzaminim ose trajtim dentar	18,1	17,9	16,2

Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2022, 2023, 2024
**Rezultatet e anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës të vitit 2023 janë rivlerësuar bazuar në të dhënat e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023.*
***Prej vitit 2024 dhe në vijim korniza e kampionimit dhe kalibrimi i rezultateve të anketës do të bazohet në Censin e Popullsisë dhe Banesave, 2023*

PËRKUFIZIM

Gjendja shëndetësore bazohet në vetë-perceptimin subjektiv të individëve dhe i referohet shëndetit në përgjithësi dhe jo problemeve të përkohshme duke përfshirë dimensionet e ndryshme të shëndetit si shëndeti mendor, emocional dhe fizik.

10 SHËNDETËSIA




SHPENZIMET PUBLIKE NË SHËNDETËSI

Shpenzimet publike në "Shëndetësi" për vitin 2025 janë 76.637 milionë lekë.

Krahasuar me vitin 2024, shpenzimet publike në "Shëndetësi" si përqindje ndaj PBB-së kanë shënuar rritje me 0,12 pikë përqindje, ndërsa si përqindje ndaj shpenzimeve publike gjithsej, kanë shënuar rënie me 0,01 pikë përqindje.

SHPENZIMET PUBLIKE NË SHËNDETËSI (%)




Burimi: Ministria e Financave, INSTAT
**2025 Të dhëna gjysmëfinale*

A E DINI SE?

Shpenzimet publike në "Shëndetësi" përbëjnë 9,57 % të shpenzimeve publike gjithsej për vitin 2025 dhe zënë një peshë prej 2,89 % ndaj PBB-së.

PËRKUFIZIM

Shpenzime Publike në shëndetësi – përfshijnë të gjitha shpenzimet që lidhen me ofrimin e shërbimeve shëndetësore, aktivitetet e planifikimit familjar, aktivitetet e të ushqyerit dhe ndihmën emergjente të caktuar për shëndetin.



11 SISTEMI I DREJTËSISË

PERSONA TË PËRFSHIRË NË SISTEMIN E DREJTËSISË

Në vitin 2025, janë regjistruar nga policia 45.334 persona të dyshuar, 13,2 % më shumë, krahasuar me vitin 2024. Të arrestuar në vitin 2025 janë 9.751 persona. Ndërkohë janë regjistruar nga policia 19.145 persona, të cilëve iu është shkelur ose rrezikuar çfarëdo e drejtë personale ose pasurore nga veprat penale.


Persona të pandehur për vepra penale, në vitin 2025 janë regjistruar 14.356, 9,0 % më shumë, krahasuar me vitin e kaluar. Gjendja e të burgosurve në IEVP në 31 dhjetor 2025 është 1.934 të dënuar me burg dhe 2.569 të paraburgosur, ndaj të cilëve është marrë masë sigurimi "arrest në burg".

PERSONA TË PËRFSHIRË NË SISTEMIN E DREJTËSISË PENALE

	2023	2024	2025
Të dyshuar	39.489	40.057	45.334
Të arrestuar	9.198	8.771	9.751
Të dëmtuar	17.021	17.761	19.145
Të pandehur	13.963	13.167	14.356
Të dënuar me burg	2.192	1.713	1.934
Të paraburgosur	2.977	2.778	2.569

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Prokuroria e Përgjithshme, INSTAT

PERSONA TË PËRFSHIRË NË SISTEMIN E DREJTËSISË PENALE




Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Prokuroria e Përgjithshme, INSTAT

A E DINI SE?

Gjatë vitit 2025, janë regjistruar mesatarisht 39,3 persona të pandehur në ditë.

PËRKUFIZIM

I pandehur: Konsiderohet personi të cilit i është atribuar vepra penale përmes aktit të njoftimit të akuzës, i cili përmban dëshmi të mjaftueshme për marrjen e personit si i pandehur.



12

SISTEMI I DREJTËSISË

VEPRA PENALE KUNDËR PERSONIT

Në vitin 2025 janë evidentuar 8.037 vepra penale kundër personit, duke shënuar një rritje prej 18,7 %, krahasuar me vitin 2024. Këto vepra përbëjnë 21,0 % të totalit të veprave penale të evidentuara gjatë vitit 2025. Ndërkohë janë regjistruar 10.501 autorë të dyshuar për vepra penale kundër personit, me një rritje prej 25,1 % krahasuar me vitin e mëparshëm.

Brenda grupit të veprave penale kundër personit, peshën më të madhe e zënë krimet kundër shëndetit, të ndjekura nga veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, si dhe krimet kundër jetës. Edhe për sa i përket autorëve të regjistruar, numri më i lartë i tyre i përket kategorisë së krimeve kundër shëndetit.

PËRKUFIZIM

Vepra penale kundër personit përfshijnë veprat që cënojnë ose rrezikojnë jetën, shëndetin, lirinë, papreksmërinë seksuale, si edhe nderin dhe dinjitetin e individit, të mbrojtura nga legjislacioni penal në fuqi.

A E DINI SE?

Gjatë vitit 2025, u evidentuan mesatarisht rreth 3,5 kanosje në ditë. Në vitin 2025, vepra dhuna në familje përbën 92,4 % të veprave të evidentuara kundër fëmijëve, martesës dhe familjes.

VEPRA PENALE KUNDËR PERSONIT, 2025

Vepra penale kundër personit	Vepra penale		Autorë	
	2024	2025	2024	2025
Krime kundër jetës	**1.197**	**1.430**	**1.424**	**1.750**
Vrasje	40	40	54	45
Vrasje mbetur tentativë	83	79	108	123
Vrasje nga pakujdesia	5	3	5	3
Kanosje	1.040	1.291	1.226	1.551
Të tjera	29	17	31	28
Krime kundër shëndetit	**2.078**	**2.636**	**3.014**	**4.122**
Plagosje e rëndë me dashje	147	168	208	282
Plagosje e lehtë me dashje	887	1.024	1.385	1.655
Dëmtime tjera me dashje	1.023	1.433	1.398	2.173
Të tjera	21	11	23	12
Krime seksuale	**142**	**158**	**150**	**172**
Vepra penale kundër lirisë së personit	**210**	**220**	**321**	**336**
Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë	56	44	90	80
Heqja e paligjshme e lirisë	25	36	56	67
Dhunim banese	85	84	89	93
Të tjera	44	56	86	96
Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit	**684**	**1.016**	**873**	**1.316**
Prostitucioni	57	118	181	341
Shfrytëzim prostitucioni	76	82	130	160
Mbajtja e lokaleve për prostitucion	33	82	81	149
Fyerja	98	85	100	94
Përndjekja	232	392	221	352
Të tjera	188	257	160	220
Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes	**2.392**	**2.516**	**2.577**	**2.755**
Braktisja fëmijës së mitur	62	48	67	50
Trafikimi i të miturit	23	13	25	18
Dhuna në familje (130/a)	2.139	2.325	2.298	2.549
Të tjera	168	130	187	138
Të tjera kundër personit	**67**	**61**	**38**	**50**
Gjithsej	**6.770**	**8.037**	**8.397**	**10.501**

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, INSTAT

13 ARSIMI



REGJISTRIME NË ARSIM

Në arsimin 9-vjeçar, u regjistruan 243.764 nxënës, ndërsa në arsimin e mesëm të lartë u regjistruan 88.837 nxënës. Pjesën më të madhe të nxënësve të regjistruar në arsimin e mesëm të lartë e përbëjnë nxënësit e gjimnazit dhe të arsimit të mesëm social-kulturor prej 80,6 %.

Më shumë se gjysma e studentëve të regjistruar janë përqendruar në tre fusha kryesore studimi: "Biznes, administrim dhe ligj" me 25,2 %, "Shëndet dhe mirëqenie" me 22,2 % dhe "Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim" me 16,9 %.

A E DINI SE?


Në arsimin pas të mesëm jo të lartë, meshkujt e regjistruar përbëjnë shumicën me 53,8 %.

NXËNËS DHE STUDENTË TË REGJISTRUAR SIPAS NIVELEVE ARSIMORE

Niveli ISCED	Viti shkollor / akademik	2023-24	2024-25	2025-26
	Të regjistruar në arsim	**536.780**	**528.602**	**515.040***
02	Në Kopshte	66.711	65.914	66.343
	Në arsimin 9 vjeçar:	258.072	250.617	243.764
1	Në fillore	141.089	136.379	132.018
2	Në ciklin e lartë të arsimit bazë	116.983	114.238	111.746
3	Në arsimin e mesëm:	91.755	89.190	88.837
	Gjimnaz dhe Social-Kulturor	75.348	72.203	71.647
	Profesional	16.407	16.987	17.190
4	Në arsimin pas të mesmes, jo të lartë	179	268	314
5-8	Në arsimin e lartë	120.063	122.613	115.782*


Burimi: Ministria e Arsimit, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, INSTAT
**Shënim: Të dhënat e arsimit të lartë nuk janë përfundimtare, për regjistrimet në programet e studimit Doktoraturë dhe Specializime Afatgjata, për vitin 2025-26.*

STUDENTË TË REGJISTRUAR SIPAS FUSHAVE TË STUDIMIT 2025-26 (NË %)



Burimi: Ministria e Arsimit, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, INSTAT

14 ARSIMI



DIPLOMIME NË ARSIM

Në vitin shkollor 2024-25, në arsimin zyrtar u diplomuan gjithsej 82.640 nxënës dhe studentë, duke shënuar një ulje prej 0,1 %, krahasuar me vitin shkollor 2023-24. Në arsimin 9-vjeçar u diplomuan 27.682 nxënës, ndërsa në arsimin e mesëm përfunduan studimet dhe u diplomuan 25.925 nxënës.

NXËNËS TË DIPLOMUAR NË ARSIM, 2022-2025

Niveli ISCED	Niveli Arsimor	2022-23	2023-24	2024-25
1+2	Në arsimin 9 vjeçar	28.488	27.705	27.682
3	Në arsimin e mesëm	27.069	26.729	25.925
	Gjimnaz dhe Social-Kulturor	23.857	23.555	22.733
	Profesional	3.212	3.174	3.192
4	Pas të mesëm, jo të lartë	-	85	94
5 - 8	Arsimi i lartë	27.991	28.193	28.939
1 - 8	Gjithsej të diplomuar	83.548	82.712	82.640

Burimi i informacionit: Ministria e Arsimit dhe Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, INSTAT


PËRKUFIZIM

Raporti bruto i diplomimit është numri i të diplomuarve pavarësisht moshës në një nivel arsimi në raport me popullsinë e moshës tipike që diplomohet në atë nivel specifik.

Në vitin 2024-25, në arsimin e lartë u diplomuan 28.939 studentë. Nga totali i të diplomuarve në të gjitha programet e arsimit të lartë, 18.892 ishin studente femra, të cilat përbëjnë 65,3 % të totalit të studentëve të diplomuar.

Më shumë se gjysma e studentëve të diplomuar janë përqendruar në tre fusha kryesore studimi: "Biznes, administrim dhe ligj" me 23,3 %, "Shëndet dhe mirëqenie" me 22,4 % dhe "Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim" me 14,0 %.

TË DIPLOMUAR NË ARSIMIN E LARTË SIPAS FUSHAVE TË STUDIMIT, 2024-25



Burimi i informacionit: Ministria e Arsimit, INSTAT

A E DINI SE?

Fusha "Biznes, administrim dhe ligj" ka numrin më të lartë të të diplomuarve, me 23,3 % të totalit.



16 ARSIMI

SHPENZIMET PUBLIKE NË ARSIM

Shpenzimet publike në arsim për vitin 2025 janë 83.949 milionë lekë.

Krahasuar me vitin 2024, shpenzimet publike në "Arsim" si përqindje ndaj PBB-së kanë shënuar rritje me 0,25 pikë përqindje, ndërsa si përqindje ndaj shpenzimeve publike gjithsej, kanë shënuar rritje me 0,38 pikë përqindje.


A E DINI SE?

Shpenzimet publike në "Arsim" përbëjnë 10,48 % të shpenzimeve publike gjithsej për vitin 2025 dhe zënë një peshë prej 3,17 % ndaj PBB-së.

PËRKUFIZIM


Shpenzime Publike në "Arsim" – i referohen burimeve financiare të alokuara nga qeveria për të mbështetur institucionet arsimore dhe shërbime të tjera të lidhura me arsimin. Fondet e buxhetit për arsimin përbëhen nga shpenzimet e drejtpërdrejta për shkollat, universitetet dhe institucionet e tjera arsimore, si dhe subvencionet arsimore që u ofrohen familjeve.

SHPENZIMET PUBLIKE NË ARSIM



Burimi: Ministria e Financave, INSTAT
** 2025 Të dhënat për PBB-në janë gjysmë-finale*

SHPENZIMET PUBLIKE NË ARSIM (MLN LEKË)



Burimi: Ministria e Financave, INSTAT
** 2025 Të dhënat për PBB-në janë gjysmë-finale*



17
ARTI DHE KULTURA

ARTI DHE KULTURA

Në vitin 2025, në institucionet e artit janë organizuar 1.272 shfaqje dhe premiera, ndjekur nga 171.607 spektatorë. Krahasuar me vitin 2024 pjesëmarrja mesatare e spektatorëve në institucionet e artit në vitin 2025 ka pësuar rënie.

NUMRI I SHFAQJEVE DHE SPEKTATORËVE NË INSTITUCIONET QËNDRORE TË ARTIT, 2022-2025

Viti	Numri i shfaqjeve dhe premierave	Numri i spektatorëve	Pjesëmarrja mesatare
2025	1.272	171.607	135
2024	1.282	268.909	210
2023	1.175	153.041	130
2022	954	125.675	132

Burimi: Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, INSTAT




A E DINI SE?

Në vitin 2025, numri mesatar i spektatorëve për shfaqje është 135.

Në vitin 2025, numri i artistëve të huaj, të ardhur në Shqipëri, sipas vendit të origjinës, rezultoi 428. Arabia Saudite shënon praninë më të lartë të artistëve të huaj në aktivitetet kulturore në Shqipëri, me 29,7 % të totalit të artistëve të ardhur, e ndjekur nga Kosova (11,7 %), Italia (9,8 %) dhe Gjermania (6,8 %).

PËRQINDJA E ARTISTËVE TË HUAJ TË ARDHUR NË SHQIPËRI, 2025



Burimi: Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, INSTAT

PËRKUFIZIM

Pjesëmarrja mesatare e spektatorëve për shfaqje llogaritet me numrin total të spektatorëve në institucionet kulturore me numrin e shfaqjeve të realizuara në këto institucione.

18


TRASHËGIMI KULTUROR



TRASHËGIMI KULTURORE


Numri i vizitorëve në Muze, Kala e Monumente të tjera si dhe në Parqe Arkeologjike për vitin 2025 është 1.523.587 vizitorë. Parqet arkeologjike janë objektet me të preferuara nga vizitorët ku frekuentohen nga 41,1 % e vizitorëve gjithsej. Në institucionet e trashëgimisë kulturore 66,0 % e vizitorëve janë të huaj.

VIZITORË NË MUZE, PARQE ARKEOLOGJIKE DHE KALA, 2025



Burimi: Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, INSTAT

PËRQINDJA E VIZITORËVE TË HUAJ NË MUZE, KALA E MONUMENTE TË TJERA DHE PARQE ARKEOLOGJIKE, 2024-2025



Burimi: Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, INSTAT

A E DINI SE?

Parqet arkeologjike janë pasuritë të cilat janë frekuentuar më së shumti nga vizitorët e huaj.

PËRKUFIZIM

Koncepti i trashëgimisë kulturore shoqërohet me tërësinë e pasurive kulturore, të cilat shprehin vlerat, identitetin, njohuritë, traditat, besimet si dhe pasuritë kulturore të një shoqërie. Trashëgimia kulturore identifikohet me monumente, muze, vende arkeologjike, parqe dhe kala etj.



19

SHPENZIMET PUBLIKE NË ARGËTIM, KULTURË DHE ÇËSHTJE FETARE

SHPENZIMET PUBLIKE NË ARGËTIM, KULTURË DHE ÇËSHTJE FETARE

Shpenzimet publike në "Argëtim, Kulturë dhe Çështje Fetare" për vitin 2025 janë 13.215 milionë lekë.

Krahasuar me vitin 2024, shpenzimet publike në "Argëtim, Kulturë dhe Çështje Fetare" si përqindje ndaj PBB-së kanë shënuar rritje me 0,05 pikë përqindje, ndërsa si përqindje ndaj shpenzimeve publike gjithsej, kanë shënuar rritje me 0,09 pikë përqindje.


A E DINI SE?

Shpenzimet publike në "Argëtim, Kulturë dhe Çështje Fetare" përbëjnë 1,65 % të shpenzimeve publike gjithsej për vitin 2025 dhe zënë një peshë prej 0,50 % ndaj PBB-së.

PËRKUFIZIM

Shpenzimet e qeverisë për argëtimin, kulturën dhe fenë përfshijnë shpenzimet e realizuara për shërbimet që u ofrohen individëve dhe familjeve dhe shpenzimet për shërbimet e ofruara në baza kolektive.

SHPENZIMET PUBLIKE PËR ARGËTIMIN, KULTURËN DHE ÇËSHTJET FETARE, 2015-2025



Burimi: Ministria e Financave (MF); Instituti i Statistikave (INSTAT)
2025 Të dhëna gjysmëfinale*



20 PUNËSIMI

PUNËSIMI

Në vitin 2025, shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç është 69,3 %. Shkalla e punësimit për meshkujt 15-64 vjeç në vitin 2025 ishte 76,0 %, ndërsa për femrat 62,7 %, me një hendek gjinor në punësim prej 13,3 pikë përqindje.


Në nivel vendi, Bujqësia përbën 33,8 % të punësimit gjithsej, e ndjekur nga Tregtia, Transporti, Hoteleria, Shërbimet e biznesit dhe administrative me 28,0 % në vitin 2025.

Në vitin 2025, 25 % e femrave të punësuara janë punëtore pa pagesë në biznesin familjar kundrejt 12,6 % të meshkujve të punësuar

Në vitin 2025 përqindja e punësimit informal në sektorin jo-bujqësor është 21,8 %, duke pësuar një ulje me 2,9 pikë përqindje krahasuar me vitin 2024.

PËRKUFIZIME

Punësimi informal përfshin punonjësit jo në sektorin bujqësor, për të cilët marrëdhëniet ekonomike me punëdhënësin nuk mbulohen ose mbulohen pjesërisht nga marrëveshjet formale, si: punonjësit që nuk përfitojnë pushim vjetor me pagesë apo pushim mjekësor me pagesë në rast sëmundjeje, apo punonjësit që përfitojnë pushim vjetor të paguar dhe pushim mjekësor të paguar, por punëdhënësit e tyre nuk paguajnë kontribute për sigurimet shoqërore për ta.



Burimi: EUROSTAT dhe INSTAT

STATUSI NË LIDHJE ME PUNËSIMIN E POPULLSISË 2023-2025

	Njësia	2023	2024	2025
Popullsia gjithsej	**1.000**	**2.762**	**2.391**	**2.363**
Forcat e punës gjithsej	-	**1.195**	**1.167**	**1.149**
• Meshkuj	-	634	623	614
• Femra	-	561	544	535
Të punësuar gjithsej	-	**1.074**	**1.057**	**1.042**
• Meshkuj	-	571	568	564
• Femra	-	503	489	478
Shkalla e punësimit*	%	**67,7**	**68,6**	**69,3**
• Meshkuj	-	73,0	74,9	76,0
• Femra	-	62,7	62,4	62,7

Burimi: Anketa e Forcave të Punës, INSTAT
**) llogaritur mbi popullsinë 15-64 vjeç*

A E DINI SE?

Punësimi informal në sektorin jo-bujqësor pësoi rënien më të madhe në vitin 2025, duke u ulur me 2,9 pikë përqindje krahasuar me vitin 2024.



21 PAPUNËSIA

PAPUNËSIA

Tregu shqiptar i punës, gjatë vitit 2025, u karakterizua nga një ulje prej 0,1 pikë përqindje e shkallës së papunësisë. Krahasuar me një vit më parë shkalla e papunësisë, në këtë vit, arriti në 9,3 % për popullsinë e grupmoshës 15-64 vjeç, nga 9,4 % që u vlerësua në 2024.

Shkalla e papunësisë ka pësuar ulje për meshkujt ndërsa rritje për femrat, krahasimisht me vitin 2024. Ky tregues është 8,2 % për meshkujt dhe 10,6 % për femrat në vitin 2025.


Gjatë vitit 2025, shkalla e papunësisë për popullsinë e grupmoshës 25-54 vjeç, niveli i papunësisë në vitin 2025 ka pësuar ulje në 8,6 %, nga 9,0 % që ishte në vitin 2024.

Të rinjtë e grup-moshës 15-29 vjeç të cilët nuk janë as në punësim e as duke vazhduar shkollën apo ndonjë trajnim përbëjnë 20,1 % të të rinjve gjithsej për vitin 2025.

A E DINI SE?

Pjesëmarrja e të rinjve në tregun e punës dhe arsim ka shënuar një ecuri pozitive, ku përqindja e të rinjve NEET (jo në punësim dhe as në arsim) shënoi rënie më 2,7 pikë përqindje duke zbritur në 20,1 % në vitin 2025, krahasuar me 22,8 % që regjistrohej në vitin paraardhës.

TË RINJTË (15-29 VJEÇ) SIPAS STATUSIT TË ARSIMIT DHE PUNËSIMIT, 2025 (%)



Burimi: Anketa e Forcave të Punës, INSTAT


PAPUNËSIA PËR GRUPMOSHËN 15-64 VJEÇ, 2023-2025

	Njësia	2023	2024	2025
Të papunë	**1.000**	**121**	**109**	**107**
• Meshkuj	-	63	55	50
• Femra	-	58	54	57
Shkalla e papunësisë	**%**	**10,1**	**9,4**	**9,3**
• Meshkuj	-	9,9	8,9	8,2
• Femra	-	10,3	10	10,6

Burimi: Anketa e Forcave të Punës, INSTAT

PËRKUFIZIME

Të rinjtë NEET (Jo në punësim, arsim apo trajnim) – Përfshin përqindjen e të rinjve të moshës 15–29 vjeç të cilët janë të papunë ose ekonomikisht joaktivë, dhe që në të njëjtën kohë nuk ndjekin asnjë cikël shkollor apo trajnim profesional.



22 ÇMIMET E KONSUMIT

ÇMIMET E KONSUMIT

Ndryshimi mesatar vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit në vitin 2025 është 2,2 %. Kontributin kryesor në rritjen mesatare vjetore të çmimeve e dha grupi "Ushqime dhe pije joalkoolike" me +0,89 pikë përqindje, me një rritje mesatare vjetore me 2,6 %, pasuar nga grupi "Qira, ujë, energji elektrike, gaz dhe karburante të tjera" me një kontribut prej +0,51 pikë përqindje dhe një rritje mesatare vjetore me 2,5 %. "Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë", me një kontribut prej +0,22 pikë përqindje, me nje rritje mesatare vjetore 3,2 %. "Pije alkolike dhe duhan", me një kontribut +0,17 pikë përqindje dhe një rritje mesatare vjetore 3,5 %, etj.


A E DINI SE?

Në vitin 2025 indeksi i çmimeve të konsumit të nëngrupit "Vajra dhe yndyrna" shënoi një rritje 5,5 % nga -2,7 % që ishte një vit më parë.

PËRKUFIZIM

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) është përcaktuar si matësi i ndryshimit mesatar të çmimeve të një shporte fikse mallrash dhe shërbimesh, e cila blihet nga familjarët dhe synon të plotësojë nevojat e tyre.

NDRYSHIMI MESATAR VJETOR I IÇK (%)



Burimi: INSTAT

NDRYSHIMI MESATAR VJETOR I IÇK SIPAS GRUPEVE (%)

		2023	2024	2025
	Gjithsej	**4,8**	**2,2**	**2,2**
01.	Ushqime dhe pije joalkoolike	9,4	2,6	2,6
02.	Pije alkoolike dhe duhan	3,8	3,5	3,5
03.	Veshje dhe këpucë	3,8	3,5	1,8
04.	Qira, ujë, energji elektrike, gaz dhe karburante të tjera	2,3	1,9	2,5
05.	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	5,4	3,6	3,2
06.	Shëndeti	1,2	1,5	0,6
07.	Transporti	-7,2	-2,0	-0,8
08.	Informacioni dhe komunikimi	1,0	0,4	1,1
09.	Argëtim, sport dhe kulturë	6,3	4,9	6,7
10.	Shërbimi arsimor	2,3	1,7	1,3
11.	Restorante dhe shërbime akomodimi	4,8	2,5	2,0
12.	Sigurime dhe shërbime financiare	0,1	-0,1	1,4
13	Kujdes personal dhe mallra e shërbime të ndryshme	5,9	3,9	1,3

Burimi: INSTAT

23

PRODUKTI I BRENDSHËM BRUTO



PRODUKTI I BRENDSHËM BRUTO

Metodat e përdorura në Shqipëri për llogaritjen e PBB-së janë metoda e prodhimit, shpenzimeve dhe e të ardhurave.

Në vitin 2025, ekonomia shqiptare shënoi një rritje në terma realë (në volum) prej 3,79 %, krahasuar me vitin 2024, bazuar kjo mbi vlerësimin paraprak të PBB-së mbështetur në vlerësimet tremujore.

Në vitin 2024, rritja ekonomike në terma real është 4,05 %, krahasuar me vitin 2023.

A E DINI SE?

Kontributin më të lartë në rritjen e PBB-së e kanë dhënë aktivitetet e Shërbimeve me +2,78 pikë përqindje.

PËRKUFIZIM

PBB përfaqëson vlerën gjithsej në para të të gjithë të mirave dhe shërbimeve të prodhuara gjatë një periudhe specifike nga njësitë prodhuese rezidente brenda territorit ekonomik të një vendi.

LLOGARITË KOMBËTARE

	Njësia	2022	2023	2024	2025*
Burimet (me çmime korrente)	Mln lekë	3.170.890	3.402.989	3.604.757	3.778.157
PBB me çmime tregu	Mln lekë	2.149.742	2.364.276	2.517.820	2.650.990
Importet e mallrave e shërbimeve (fob)	-	1.021.148	1.038.713	1.086.937	1.127.166
Përdorimet (me çmime korrente)	-	3.170.889	3.402.989	3.604.757	3.778.157
Eksportet e mallrave e shërbimeve (fob)	-	799.641	908.327	913.588	981.241
Konsumi Final i Popullatës	-	1.516.004	1.639.362	1.735.230	1.817.742
Konsumi Final i Administratës Publike dhe i Institucioneve Jo-Fitimprurëse	-	279.063	301.131	327.705	357.066
Formimi Bruto i Kapitalit Fiks	-	552.372	574.200	613.221	643.300
Ndryshimet e gjendjeve	-	23.810	(20.031)	15.013	(21.193)
Rritja vjetore e PBB (krahasuar me çmimet e vitit të mëparshëm)	**%**	**4,83**	**4,02**	**4,05**	**3,79**
Produkti i Brendshëm Bruto për frymë	1.000 lekë	774	984	1.053	1.122
	Euro	6.505	9.046	10.456	11.456
	USD	6.840	9.780	11.312	12.918

2025 Të dhëna gjysëmfinale*



24

PRODUKTI I BRENDSHËM BRUTO


PRODUKTI I BRENDSHËM BRUTO

Metoda e prodhimit

Në vitin 2025 rritjen më të lartë në terma realë e shënuan aktivitetet e "Shërbimet" me 5,7%, pasuar nga aktiviteti i "Ndërtimi" me 4,59 %.

Metoda e shpenzimeve

Në vitin 2025, Konsumi final përbën peshën kryesore të shpenzimeve në ekonomi, me 82,04 % dhe u rrit me 3,85 % në terma realë. Formimi bruto i kapitalit fiks u rrit me 5,02 %, eksportet u rritën me 7,42 % dhe importet me 3,62 % në terma realë.



2025 Të dhëna gjysmëfinale*

PËRKUFIZIME

PBB sipas metodës së prodhimit matet si shumë e vlerës së shtuar të të gjitha aktiviteteve ekonomike plus taksat minus subvencione mbi produktet.

PBB sipas metodës së shpenzimeve përfshin vlerësimet e shpenzimeve të katër sektorëve të ekonomisë: Familjeve, Ndërmarrjeve, Qeverisë dhe Sektorit të Jashtëm.

A E DINI SE?

Konsumi Final i Popullatës zë 68,57 % dhe shënoi rritje në terma realë 2,77 %. Konsumi final i Administratës Publike zë 12,85 % dhe shënoi rritje në terma reale 9,95 %.



25

TREGTIA E JASHTME

TREGTIA E JASHTME


Në vitin 2025 volumi tregtar i mallrave është ulur me 2,4 % krahasuar me 2024, duke patur një ulje vjetore 6,1 % për eksportet dhe 0,8 % për importet.

Grupet më të rëndësishme të mallrave që eksporton Shqipëria janë: "Produkte minerale" dhe "Tekstile dhe artikuj tekstile" duke zënë respektivisht 18,2 %, dhe 17,1 % të eksporteve gjithsej. Grupet më të rëndësishme të mallrave që importon Shqipëria janë: "Makineri e pajisje mekanike dhe elektrike" dhe "Produkte minerale", duke zënë respektivisht 15,5 % dhe 11,2 % të importeve gjithsej.

Tre nga partnerët kryesorë për eksportet, për vitin 2025, janë Itali, Kosovë dhe Greqi, duke zënë 58,6 % të eksporteve shqiptare. Për importet, tre nga partnerët kryesorë janë Itali, Kinë dhe Turqi duke zënë 43,9 % të importeve shqiptare.


PËRKUFIZIME

Tregtia e jashtme e mallrave përfshin eksportet dhe importet e mallrave midis Shqipërisë dhe vendeve të tjera.
Eksportet janë mallra që dërgohen drejt vendeve të tjera dhe llogariten me vlerën FOB (kostoja e mallit deri në kufirin e vendit eksportues), ndërsa importet janë mallra që hyjnë nga vende të tjera dhe llogariten me vlerën CIF (kostoja e mallit, transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit importues).



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, INSTAT

PESË PARTNERËT KRYESORË TREGTARË, 2025



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, INSTAT

TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE (MILION LEKË)

	2005	2010	2015	2020	2025
Eksporte (FOB)	65.818	161.548	243.183	271.955	346.149
Importe (CIF)	262.191	477.768	544.616	605.262	887.285
Bilanci tregtar (eksporte+importe)	-196.373	-316.220	-301.433	-333.307	-541.137
Volumi tregtar (eksporte+importe)	328.009	639.315	787.799	877.217	1.233.434
Përqindja e mbulimit (%)	25,1	33,8	44,7	44,9	39,0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, INSTAT



26 INOVACIONI

INOVACIONI

Bazuar në Vrojtimin mbi Aktivitetin e Inovacionit në Ndërmarrje, për periudhën referuese 2022–2024, rezulton se 44,3 % e ndërmarrjeve me 10 ose më shumë të punësuar kanë ndërmarrë aktivitete inovacioni. Në këtë kategori përfshihen ndërmarrjet që kanë prezantuar inovacione në produkte ose procese biznesi, si edhe ato që kanë pasur aktivitete inovative të papërfunduara ose të braktisura gjatë periudhës së vrojtuar.

Aktiviteti i inovacionit është më i lartë në sektorin e shërbimeve (seksionet G, H, J, K dhe M të NVE Rev. 2), ku 46,7 % e ndërmarrjeve kanë raportuar aktivitete inovative. Ndërkohë, në sektorin e industrisë (seksionet B, C, D dhe E të NVE Rev. 2), kjo përqindje rezulton 41,6 %. Krahasuar me vrojtimin e mëparshëm për periudhën 2020–2022, niveli i aktivitetit të inovacionit ka shënuar rritje, nga 42,9 % në 44,3 %.

PËRQINDJA E NDËRMARRJEVE AKTIVE DHE JO AKTIVE NË INOVACION SIPAS SEKTORËVE EKONOMIKË DHE MADHËSISË SË NDËRMARRJES, 2018-2024

	Ndërmarrje aktive në Inovacion			Ndërmarrje jo aktive në Inovacion		
	2018-2020	2020-2022	2022-2024	2018-2020	2020-2022	2022-2024
Gjithsej	**36,6**	**42,9**	**44,3**	**63,4**	**57,1**	**55,7**
Aktiviteti ekonomik						
Industri	**32,1**	**39,3**	**41,6**	**67,9**	**60,7**	**58,4**
Shërbime	**41,0**	**46,0**	**46,7**	**59,0**	**54,0**	**53,3**
Madhësia e ndërmarrjes						
10-49 të punësuar	**32,1**	**32,1**	**40,9**	**67,9**	**67,9**	**59,1**
50-249 të punësuar	**49,0**	**49,0**	**54,3**	**51,0**	**51,0**	**45,7**
250+ të punësuar	**68,2**	**68,2**	**66,4**	**31,8**	**31,8**	**33,6**

Burimi: Anketat mbi inovacionin në ndërmarrje, INSTAT

PËRKUFIZIME

Një inovacion: Është një produkt ose proces i ri ose i përmirësuar (ose kombinimi i tyre) që ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga produktet ose proceset e mëparshme të njësisë dhe që është vënë në dispozicion të përdoruesve të mundshëm ose është sjellë në përdorim nga njësia.

A E DINI SE?

Ndërmarrjet aktive në inovacion luajnë një rol kyç në ekonomi. Në vitin 2024, ato realizuan 62,1 % të shitjeve neto totale të ndërmarrjeve të vrojtuara dhe punësuan 57,8 % të të punësuarve. Kjo tregon se ndërmarrjet që investojnë në inovacion kanë një peshë më të madhe në treg dhe në krijimin e vendeve të punës.




26 INOVACIONI

INOVACIONI

Sektori i Shërbimeve

- Aktivitetet e Informacionit dhe Komunikacionit rezultojnë me nivelin më të lartë të inovacionit, ku 67,9 % e ndërmarrjeve janë aktive në inovacion.
- Ndërmarrjet në aktivitetet Financiare dhe të Sigurimit kanë rezultuar aktive në inovacion me 55,1 %.

PËRQINDJA E NDËRMARRJEVE ME INOVACIONE TË PRODUKTEVE DHE PROCESEVE NË BIZNES SIPAS SEKTORËVE EKONOMIKË, 2022-2024 (%)




Burimi: Anketat mbi inovacionin në ndërmarrje, INSTAT

Sektori i Industrisë

- Ndërmarrjet në aktivitetin e Energjisë elektrike, furnizimit me gaz, avull dhe ajër të kondicionuar kanë rezultuar aktive në inovacion me 45,0 %.
- Në Industrinë Përpunuese, 43,3 % e ndërmarrjeve kanë rezultuar aktive në inovacion.

NDËRMARRJE ME INOVACIONE TË PRODUKTEVE DHE PROCESEVE NË BIZNES SIPAS MADHËSISË SË NDËRMARRJEVE, 2022-2024, (%)



Burimi: Anketat mbi inovacionin në ndërmarrje, INSTAT

Gjetjet kryesore mbi aktivitetin e inovacionit krahasuar me periudhën paraardhëse, 2020–2022:

Rezultatet e vrojtimit tregojnë se rritja e aktiviteteve inovative ka ndikuar pozitivisht në rritjen e të ardhurave nga shitja (shitjet neto) dhe në zgjerimin e punësimit në ndërmarrje.

- Shitjet neto të realizuara nga ndërmarrjet aktive në inovacion janë rritur me 4,1 pikë përqindjeje. Në vitin 2024, këto shitje përbënin 62,1 % të totalit të shitjeve neto të ndërmarrjeve të vrojtuara.
- Numri i të punësuarve në ndërmarrjet aktive në inovacion është rritur me 4,3 pikë përqindjeje. Në vitin 2024, të punësuarit në këto ndërmarrje përfaqësonin 57,8 % të totalit të të punësuarve në ndërmarrjet e vrojtuara.



27

TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT (TIK) NË NDËRMARRJE

Gjatë vitit 2025, 99,4 % e ndërmarrjeve me 10 e më shumë të punësuar kanë përdorur kompjuter me akses në internet për qëllime pune.


Punonjës që kanë patur akses në internet përbëjnë 32,4 % e të punësuarve gjithsej gjatë vitit 2025. Gjatë vitit 2025, 91,8 % e ndërmarrjeve kanë përdorur internet me shpejtësi maksimale shkarkimi mbi 30 Mbit/s.

Në vitin 2025, ndërmarrjet që kanë përdorur faqen e tyre të internetit përbëjnë 61,0 % të ndërmarrjeve që përdorin kompjuter me akses në internet, ndërkohë 86,5 % e ndërmarrjeve që përdorin kompjuter me akses në internet kanë përdorur mediat sociale (të tilla si Facebook, LinkedIn, Twitter, Youtube, Pinterest, etj.).

Treguesit e përdorimit të TIK (%)	2023	2024	2025
Ndërmarrje që kanë akses në internet	99,1	99,3	99,4
Ndërmarrje që kanë faqe internet (website)	54,9	57,7	61,0
Ndërmarrje që përdorin mediat sociale për qëllime pune	80,5	83,1	86,5
Ndërmarrje që shesin produkte/shërbime online	14,8	24,5	28,0
Ndërmarrje me shpejtësi max shkarkimi >=30 Mbit/s	83,5	88,0	91,8

Burimi: Anketa mbi Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Ndërmarrje, 2023-2025.

NDËRMARRJE QË SHESIN PRODUKTE /SHËRBIME ONLINE, 2025



Burimi: Anketa mbi Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Ndërmarrje, 2025

A E DINI SE?

59,5 % e ndërmarrjeve të cilat kanë faqe web përdorin dhe një nga mediat sociale si Facebook, Instagram, Linkedin.

72,1 % e ndërmarrjeve të cilat kanë blerë shërbimet cloud gjatë vitit 2025, aplikojnë software-in për menaxhimin e marrëdhënieve me klientët (CRM), i cili lehtëson komunikimin me klientin dhe ndihmon në gjurmimin e interesave të klientëve, etj



27

TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT (TIK) NË NDËRMARRJE

Në vitin 2025, 28,0 % e ndërmarrjeve kanë shitur produkte/shërbime nëpërmjet faqes së internetit, aplikacioneve të dedikuara, faqeve të internetit e-commerce dhe aplikacioneve të përdorura nga ndërmarrje të ndryshme për tregti të produkteve, duke shënuar një rritje prej 3,5 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2024.

Peshën më të madhe e zënë ndërmarrjet që ushtrojnë aktivitet në fushën e Informacionit dhe komunikimit me 48,2 %, pasuar nga aktivitetet e Shërbime administrative dhe mbështetëse me 44,8 % dhe aktivitetet Pasuritë e patundshme me 43,3 %.

Gjatë vitit 2025 vlera e xhiros së realizuar nga shitjet online rezultoi 10,1 % duke pësuar një rritje prej 0,6 pikë përqindje, në krahasim me vitin 2024.

TIK NË NDËRMARRJE SIPAS MADHËSISË SË NDËRMARRJES (%), 2025

Madhësia e ndërmarrjes	Ndërmarrje që kanë akses në internet	Ndërmarrje që shesin produkte/ shërbime online	Ndërmarrje që përdorin një nga llojet e medias sociale
Gjithsej	**99,4**	**28,0**	**86,5**
10-49 të punësuar	99,5	30,7	85,5
50-249 të punësuar	99,3	14,2	90,3
250+ të punësuar	100	27,9	98,4

Burimi: Anketa mbi Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Ndërmarrje, 2025

PËRQINDJA E XHIROS SË REALIZUAR NGA SHITJET ONLINE NDAJ SHITJEVE TOTALE, SIPAS MADHËSISË SË NDËRMARRJES, 2025

Madhësia e ndërmarrjes	Shitje online, (%)
Gjithsej	**10,1**
250+ të punësuar	9,9
50-249 të punësuar	10,1
10-49 të punësuar	11,9

Burimi: Anketa mbi Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Ndërmarrje, 2025

PËRKUFIZIM

Anketa mbi përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) dhe tregtinë elektronike në ndërmarrje është një anketë me periodicitet vjetor e cila mbledh të dhëna për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, të tilla si p.sh. aksesi në interneti, përdorimi i faqeve të internetit, përdorimi i mediave sociale, tregtia elektronike (e-commerce), siguria e TIK-ut, inteligjenca artificiale (IA), shërbimet e informatikës cloud etj.



27

TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT (TIK) NË FAMILJE DHE INDIVIDË

Përdorimi i TIK nga individët e grupmoshës 16 - 74 vjeç

Në vitin 2025, 87,2 % e popullsisë nga 16 - 74 vjeç e përdorin internetin në "tre muajt e fundit" nga momenti i kryerjes së intervistës, prej të cilëve 97,3 % e përdorin disa herë gjatë ditës dhe 0,3 % (të paktën një herë në javë). Përqindja e individëve të moshës 16 - 74 vjeç që kryejnë thirrje/video thirrje (përmes Skype, Viber, WhatsApp) gjatë tre muajve të fundit nga momenti i kryerjes së intervistës, në vitin 2025 është 99,1 %. Shpërndarja e individëve që kryejnë thirrje / video thirrje (përmes Skype, Viber, WhatsApp) "gjatë tre muajve të fundit" tregon se grup-mosha 35-44 vjeç ka shënuar përqindjen më të lartë me 18,2 % ndjekur nga grup-mosha 55-64 me 17,9 %.

Familjet me akses në internet

Përqindja e familjeve shqiptare që kanë akses në internet në vitin 2025 është 97,7 %, krahasuar me 97,1 % të një viti më parë.


Përdorimi i e-blerje (blerje online)

Blerjet "online" i referohen porosive të mallrave ose shërbimeve nëpërmjet internetit, (e-blerje) për qëllime personale nëpërmjet çdo lloji pajisjeje (desktop, i lëvizshëm ose i dorës, përfshirë telefonin celular ose telefon smart). Blerjet "online" janë kryer nga 45,4 % e popullsisë së grupmoshës 16 - 74 vjeç në 12 muajt e fundit, nga momenti i kryerjes së intervistës.

Përdorimi i e-qeverisjes

Në vitin 2025, kontaktet elektronike nëpërmjet internetit me autoritetet publike kanë shënuar rritje: "Marrja e informacionit nga faqet ose aplikacionet e internetit" me 2,2 pikë përqindje ndjekur nga "Shkarkimi apo printimi i formularëve zyrtarë" 0,5 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2024."

PËRDORIMI I E-QEVERISJES 2024-2025 (%)




Burimi: Anketa mbi Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në NjEF, 2025

PËRKUFIZIM

Interneti është sistemi rrjeteve kompjuterike të ndërlidhura që përdor Suitën e Protokollit të Internetit (TCP/IP) për të lidhur miliarda pajisje në të gjithë botën. Ai është një rrjet i rrjeteve që përbëhet nga miliona rrjete private, publike, akademike, biznese, dhe qeveritare, me fushëveprim lokal deri në global, të lidhura nga një koleksion i gjerë elektronik, wireless, dhe teknologjitë e rrjeteve optike.

28 BUJQËSIA



BIMËT E ARAVE

Sipërfaqja e mbjellë e tokës bujqësore për vitin 2025 është 470 mijë hektarë. Struktura e mbjelljeve sipas kategorive të kulturave tregon që pjesën më të madhe, 81,5 % e zënë bimët e arave; 11,9 % e zënë ullinjtë, dhe pjesa tjetër përbëhet nga pemët frutore 4,3 %, vreshtat 2,0 % dhe agrumet 0,3 %.

Bimët e arave

Në vitin 2025 prodhimi i bimëve të arave është 9.092 mijë tonë ku perimet përbëjnë 1.445 mijë tonë. Ndër bimët e arave, bimët aromatike, mjekësore dhe erëzat e gatimit kanë shënuar një rritje prej 13,1 % krahasuar me vitin 2024.

PRODHIMI I BIMËVE TË ARAVE 000/ton

Bimët e arave	2023	2024	2025
Gjithsej bimë arash	9.371,2	9.207,6	9.091,9
Drithëra	701,3	649,9	624,0
Perime & bostanore	1.384,5	1.424,4	1.445,3
Patate	274,2	277,8	257,8
Fasule	23,3	24,4	22,5
Bimë industriale	23,4	21,6	20,9
Bimë aromatike, mjekësore dhe erëza gatimi	17,8	19,2	21,0
Luleshtrydhe	6,4	6,5	5,8
Foragjere të njoma	6.940,3	6.783,8	6.694,6


Burimi i informacionit: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, INSTAT

Për kategorinë e perimeve, prodhimi i tyre përfaqësohet nga perimet e njoma me 65,8 % (951.447 tonë), bostanoret me 25,4 % (366.675 tonë) dhe perimet e thata 8,8 % (127.165 tonë).

A E DINI SE?

Në vitin 2025, qarku me nivelin më të lartë të prodhimit të perimeve në serrë është Berati me 68,6 % të prodhimit total të perimeve.

STRUKTURA E PRODHIMIT TË PERIMEVE, 2025



Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, INSTAT

Prodhimi në serrë zë 22,1 % të prodhimit të perimeve gjithsej, ku kultura e domates përfaqëson 45,8 % të prodhimit gjithsej në serrë.

PRODHIMI I PERIMEVE NË SERRA 000/ton

Perime në serra	2023	2024	2025
Gjithsej perime në serra	**310**	**323**	**320**
• Domate	156	155	147
• Spec	44	52	54
• Kastravec	75	78	77
• Bostane	7	9	11
• Të tjera perime në serra	28	29	31

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, INSTAT

PËRKUFIZIME

Statistikat e bujqësisë mbulojnë sipërfaqen, prodhimin dhe rendimentin e drithërave, bimëve industriale, perimeve, pemëve frutore, agrumeve, ullirit dhe vreshtave.
Serrë është ambjenti i mbuluar me xham apo me mbulesë të lartë, të fiksuara apo të lëvizshme.



28 BUJQËSIA


DRUFRUTORËT


Në vitin 2025, prodhimi gjithsej i drufrutorëve është 639 mijë tonë. Peshën më të madhe në strukturën e prodhimit te tyre e zënë pemët frutore me 39,7 %, pasuar nga rrushi me 28,6 % dhe ullinjtë me 22,4 %.

PERMANENT CROPS PRODUCTION 000/tonnes

Permanent crops	2023	2024	2025
Total	**636**	**680**	**639**
Fruit trees	282	291	253
Olives	118	147	143
Citrus	57	59	59
Total Grapes*	180	183	183

Source: Ministry of Agriculture and Rural Development
**) Includes the production of grapes from vineyards and pergola.*





A E DINI SE?

Në vitin 2025, prodhimi i ullirit në qarqet Fier dhe Elbasan përfaqëson 52,1 % të prodhimit gjithsej në vend.

PËRKUFIZIME

Sipërfaqja me drufrutorë, është sipërfaqja e tokës e zënë me pemë frutore, ullinj, agrume dhe vreshta. Llogaritet vetëm sipërfaqja e mbjellë në blloqe me kultura drufrutorë.



29 BLEGTORIA

BLEGTORIA

Gjatë vitit 2025, numri i gjedhëve është 274.993 krerë. Kategoria kryesore përfaqësohet nga lopët e qumështit me 82,2 % ndaj numrit gjithsej të krerëve.

Numri i të leshtave gjatë vitit 2025, është 1.166.016 krerë. Kategoria kryesore e të leshtave përbëhet nga delet e qumështit me rreth 79,9 % ndaj numrit gjithsej të krerëve.

Gjatë vitit 2025, numri i të dhirtave është 569.701 krerë. Kategoria kryesore përfaqësohet nga dhitë e qumështit me 80,9 % ndaj numrit gjithsej të krerëve.

Prodhimi i qumështit nga fermat në vitin 2025, është rreth 868 mijë tonë. Struktura e prodhimit të qumështit është: qumësht lope 85,7 %, qumësht dhie 7,2 % dhe qumësht dele me 7,1 %.

NUMRI I BAGËTIVE, (000 KRERË)

Tregues	2023	2024	2025
Gjedhë	**263,4**	**272,0**	**275,0**
• Lopë	232,4	224,3	226,0
Të imta	**1.846,4**	**1.791,7**	**1.735,7**
Të leshta	1.206,2	1.176,5	1.166,0
• Dele	1.006,3	968,3	931,8
Të dhirta	**640,2**	**615,2**	**569,7**
• Dhi	512,0	500,7	461,0
Derra	114,8	104,0	74,7
• Dosa	10,5	9,5	8,2
Njethundrakë	**66,6**	**58,4**	**56,6**
Shpendë	**7.031,4**	**6.991,5**	**6.953,2**
Bletë (koshere)	**518,8**	**587,3**	**644,9**

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, INSTAT

PRODHIMET BLEGTORALE, (000 TONË)

Tregues	2023	2024	2025
Qumësht	**900,6**	**876,7**	**868,3**
• Qumësht lope	765,3	744,7	744,2
• Qumësht dele	64,5	64,2	61,7
• Qumësht dhie	70,7	67,8	62,5
Mish peshë e gjallë	**135,5**	**130,3**	**133,6**
• Mish gjedhi	55,2	52,0	55,2
• Mish të imtash	45,4	43,9	44,7
• Mish derri	12,2	11,5	10,2
• Mish shpendi	22,7	22,9	23,5
Lesh (ton)	**2.443,4**	**2.409,3**	**2,374,9**
Vezë (në mil)	**894,3**	**888,1**	**836,7**
Mjaltë (ton)	**5.633,4**	**5.940,2**	**6.299,3**

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, INSTAT

A E DINI SE?

Një vëmendje dhe interes të veçantë për vitin 2025 ka marrë prodhimi i mjaltit. Ky sektor gjatë këtij viti, ka shënuar rritje me 6,0 % krahasuar me një vit më parë.

PËRKUFIZIM

Blegtoria mbulon të gjitha kafshët pavarësisht nga mosha, vendndodhja ose qëllimi i mbarështimit të tyre për përmirësim racor apo për prodhime blegtorale.

30 PESHKIMI




PESHKIMI

Në vitin 2025, zënia e peshkut nga të gjitha kategoritë ujore, ka qenë 15.153 tonë nga 16.452 tonë që ishte në vitin 2024, duke shënuar një rënie në terma vjetorë me 7,9 %. Gjatë vitit 2025, u kultivuan në rezervate dhe vaska të ndryshme të specializuara rreth 6.549 tonë peshk ose rreth 8,6 % më pak se viti 2024. Kategoritë kryesore që zënë përqindjen më të lartë të peshkimit janë, "Akuakultura" me 43,2 % dhe peshkimi "Detar" me 29,2 %, pasuar nga "Ujërat e brendshme" me 19,8 %, ndaj prodhimit gjithsej.

PESHKIMI (TONË)

Kategoritë	2023	2024	2025
Peshkimi gjithsej	**19.338**	**16.452**	**15.153**
Detar	4.259	3.869	4.426
Bregdeti	676	554	487
Laguna	218	146	134
Ujërat e brendshme	4.858	4.505	3.007
Akuakultura	9.141	7.165	6.549
Molusqe	186	213	550

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, INSTAT



Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, INSTAT

PËRKUFIZIME

Peshkimi përfshin të gjitha të dhënat e aktivitetit të flotës dhe kapacitetin prodhues të sipërfaqeve të ndryshme të peshkimit.

Aktiviteti i peshkimit i referohet të gjitha veprimtarive të lidhura me kërkimin e peshkut, vendosjen dhe tërheqjen e mjeteve të peshkimit, transferimin në bord të zënieve, trasbordimin, ruajtjen dhe transformimin në bord, vendosjen në kosha, rritjen dhe shkarkimin e peshqve dhe produkteve të peshkimit.

Të dhënat i referohen sasisë së zënies të të gjitha llojeve të specieve detare (të peshkut, krustance, molusqe etj), specieve të ujërave të ëmbla (lumenj, liqene, ujëmbledhësa, akuakulturë).

A E DINI SE?

Gjatë vitit 2025, rritjen më të madhe e ka shënuar sektori "Molusqe" me rreth 158,2 % krahasuar me vitin 2024.



31 MJEDISI

MBETJET URBANE DHE INERTE


Statistikat e mbetjeve urbane bazohen në të dhënat vjetore të agreguara në nivel kombëtar për prodhimin e treguesve standardë statistikorë, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit shqiptar dhe atij evropian. Treguesit mbi sasinë e mbetjeve për banor i referohen popullsisë rezidente dhe sasisë totale të mbetjeve urbane të menaxhuara me fonde publike, nën përgjegjësinë e bashkive në të gjithë vendin.

Në vitin 2024 u menaxhuan 0,862 milionë tonë mbetje urbane, krahasuar me 0,844 milionë tonë në vitin 2023, duke shënuar një rritje prej 2,13 %.

MBETJET URBANE DHE INERTE TË MENAXHAURA, 2024

Viti	Mbetje Urbane		Mbetje Inerte
	Mbetje Urbane (ton)	Kg/ banorë	Mbetje Inerte (ton)
2022	820.322	295	48.398
2023	844.157	351	49.774
2024*	862.241	360	48.286

Burimi i informacionit: Bashkitë / INSTAT
**Të dhënat për mbetjet e menaxhuara për kg/ban janë llogaritur duke u bazuar në popullsinë (1.01.2024)*



Burimi i informacionit: Bashkitë / INSTAT
**Të dhënat për mbetjet e menaxhuara për kg/ban janë llogaritur duke u bazuar në popullsinë (1.01.2024)*

PËRKUFIZIME


Mbetjet e ngurta urbane, janë mbetjet e ngurta familjare dhe mbetjet e tjera të ngjashme me to, të cilat menaxhohen me fonde publike si shërbime komunitare ndaj popullatës në zonat e banuara qoftë dhe përkohësisht.

Mbetje është çdo substancë ose objekt, të cilin mbajtësi e hedh, ka ndër mend ta hedhë ose i kërkohet që ta hedhë.

Mbetje inerte janë ato mbetje që në kushte natyrale nuk i nënshtrohen ndonjë transformimi të rëndësishëm fizik, kimik apo biologjik. Mbetjet inerte nuk treten, nuk digjen, nuk ndërveprojnë fizikisht dhe as nuk hyjnë në reaksione kimike, nuk biodegradojnë e nuk ndikojnë negativisht në lëndë të tjera, me të cilat bien në kontak.

A E DINI SE?

Çdo person në botë prodhon 0,74 kg mbetje në ditë.



31 MJEDISI

CILËSIA E UJËRAVE LARËS NË PLAZHET E SHQIPËRISË

PLAZHET - 2024

Në vitin 2024 plazhet me cilësinë më të mirë të ujërave rezultojnë plazhi i Dhërmi - Palasë, Jalë dhe Livadhe, ku respektivisht 100 % e stacioneve të vrojtuara janë vlerësuar me cilësi të shkëlqyer. Treguesit e cilësisë së ujërave larës në plazhet e Shqipërisë, kanë qëndruar përgjithësisht në të njëjtat nivele, me cilësi të shkëlqyer ose të mirë, në 75,0 % të tyre.

DID YOU KNOW?

About 71% of the Earth's surface is covered by water, but only around 2.5% of this water is fresh water.

DEFINITION

Data on the quality of water on the Albanian beaches refer to repeated measurements on all sea beaches. These data refer mainly to the content of bacterial colonies originating from discharges into marine waters and inland waters.

NUMBER OF WATER QUALITY MONITORING STATIONS IN BEACHES

2022	2023	2024	Beach Stations*
7	7	7	Velipojë
5	5	5	Shëngjin
21	21	21	Durrës
12	12	12	Kavajë
10	10	10	Vlorë
5	5	5	Dhërmi -Palasë
4	4	4	Himarë
3	3	3	Borsh
6	6	6	Sarandë
5	5	5	Gjiri i Lalzit
2	2	2	Qeparo
3	3	3	Ksamil
3	3	3	Livadhë
2	2	2	Jalë
3	3	3	Lukovë
3	3	3	Divjakë
2	2	2	Drimadhes
3	3	3	Spille
7	7	7	Seman- Darëzezë
6	6	6	Zvërnec - Orikum
8	8	8	Pogradec

** Shënim: Numri i stacioneve të monitoruara në plazhe*

** Cilësia shpreh shkallën në përqindje e plotësimit të standardeve cilësore sipas OBSH në plazhet përkatëse*

Burimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, INSTAT



31 MJEDISI

SHPENZIMET PUBLIKE PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Shpenzimet publike në "Mbrojtjen e mjedisit" për vitin 2025 janë 8.643 milionë lekë.

Krahasuar me vitin 2024, shpenzimet publike në "Mbrojtjen e mjedisit" si përqindje ndaj PBB-së kanë shënuar një rritje me 0,05 pikë përqindje, ndërsa si përqindje ndaj shpenzimeve publike gjithsej, kanë shënuar një rritje me 0,13 pikë përqindje.


A E DINI SE?

Shpenzimet publike në kategorinë "Mbrojtjen e Mjedisit" përbëjnë 1,08 % të shpenzimeve publike gjithsej për vitin 2025 dhe zënë një peshë prej 0,33 % ndaj PBB-së.

PËRKUFIZIM


Shpenzimet publike për mbrojtjen e mjedisit mbulojnë aspekte të ndryshme, duke përfshirë menaxhimin e mbetjeve, uljen e ndotjes, mbrojtjen e biodiversitetit dhe peizazheve. Mbrojtja e mjedisit përfshin të gjitha aktivitetet dhe veprimet që kanë si qëllim kryesor parandalimin, reduktimin dhe eliminimin e ndotjes, si dhe çdo degradim tjetër të mjedisit.

SHPENZIMET PUBLIKE PËR MBROJTJEN E MJEDISIT NË RAPORT ME PBB



2025 Të dhëna gjysmëfinale*

Burimi: Ministria e Financave, INSTAT



32 PYJET

PYJET

Pyjet e Shqiperisë, në vitin 2024, shtrihen në një sipërfaqe prej 1.146.723 hektarë, që përfaqëson 66,22 % të fondit pyjor dhe kullosor, me një vëllim të përgjithshëm të lëndës drusore 53.146.000 m³.

A E DINI SE?

Pyjet mbulojnë rreth 31,0 % të sipërfaqes së Tokës dhe prodhojnë mbi 40,0 % të oksigjenit në planet.


PËRKUFIZIM

Fond pyjor kombëtar, që përfaqësohet nga fondi pyjor publik dhe privat, është sipërfaqja e mbuluar me pyje, shkurre, toka me bimësi pyjore, përfshirë edhe sipërfaqet e zhveshura (çeltirat, shkëmbinjtë, dunat dhe ranishtat), sistemet agropyjore, brezat mbrojtës, infrastrukturën përkatëse, si dhe pasuritë jopyjore bashkëshoqëruese, të cilat krijojnë një mjedis unik me pyjet e tokën pyjore.
Pyll është sipërfaqja e tokës më e madhe se 0,5 ha, e mbuluar me drurë më të lartë se 5 metra dhe me shkallë mbulimi mbi 10 %, ose me drurë të aftë për të arritur këto pragje.


FONDI PYJOR SIPAS PRONËSISË

	Sipërfaqe (Ha)			Volumi (m³)		
	2022	2023	2024	2022	2023	2024
Pyje gjithsej	**1.146.725**	**1.147.281**	**1.146.723**	**54.063**	**53.176**	**53.146**
Pyje publikë	1.117.945	1.118.501	1.117.943	50.816	49.929	49.899
Pyje privatë	28.780	28.780	28.780	3.247	3.247	3.247

Burimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, INSTAT



Burimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, INSTAT



Burimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, INSTAT

33 BIODIVERSITETI



ZONAT E MBROJTURA

Treguesit për zonat e mbrojtura japin informacion për numrin dhe sipërfaqen e zonave të mbrojtura sipas kategorive. Në vitin 2024 numri total i zonave të mbrojtura është 777 me një sipërfaqe të përgjithshme prej 624.611 hektarë.

PËRKUFIZIM


"Zonë e mbrojtur" është një hapësirë tokësore, ujore, detare e bregdetare, e përcaktuar qartë gjeografikisht, e njohur, me kufij të qartë fizikë dhe e menaxhuar përmes mjeteve ligjore apo mjeteve të tjera të efektshme, për të arritur ruajtjen/mbrojtjen afatgjatë të natyrës, e lidhur me shërbimet e ekosistemit dhe të vlerave kulturore

RRJETI I ZONAVE TË MBROJTURA

	Numri i zonave të mbrojtura			Sipërfaqja e zonave të mbrojtura (ha)		
	2022	2023	2024	2022	2023	2024
Gjithsej	**768**	**776**	**777**	**608.684**	**626.045**	**624.611**
Parqe Kombëtare	11	13	12	301.197	315.304	313.924
Monument natyre	723	724	724	1.550	1.585	86
Rezervat Natyror i Menaxhuar	24	30	28	224.014	222.049	217.385
Peisazh i mbrojtur (tokë,det,ujë)	10	9	11	81.923	87.107	81.917
Zonë e Mbrojtur e Burimeve të menaxhuara			2			11.300


Burimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombetare e Zonave te Mbrojtura.
Shënim: Në vitin 2022-2023, pas procesit të rishikimit të kufijve dhe të vlerësimit, rrjeti i zonave të mbrojtura përcaktohet me 4 (katër) kategori

NUMRI I ZONAVE TË MBROJTURA



Burimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombetare e Zonave te Mbrojtura, INSTAT

SIPËRFAQJA E ZONAVE TË MBROJTURA (HA)



Burimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombetare e Zonave te Mbrojtura, INSTAT

34 TRANSPORTI



TRANSPORTI

Gjatë vitit 2025, numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linja ajrore është rritur me 8,7 % dhe numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja detare është rritur me 6,4 % krahasuar me një vit më parë.

Në vitin 2025, numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linja ajrore ishte 11.640.070 pasagjerë gjithsej, i ndjekur nga numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linja detare me 1.696.649 pasagjerë gjithsej.

Në vitin 2025, janë transportuar me linja detare rreth 32,3 % e volumit të eksportit të mallrave dhe 65,3 % e volumit të importit të mallrave.

TREGUESIT E TRANSPORTIT AJROR, 2023-2025

	2023	2024	2025
Numri i fluturimeve	51.050	68.578	70.124
Numri i mbikalimeve	254.886	304.760	334.275
Numri i shoqërive ajrore	23	31	32


Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, INSTAT

LËVIZJA E MALLRAVE SIPAS MËNYRËS SË TRANSPORTIT, 2025

	Volumi i Eksportit		Volumi i Importit	
	mijë ton	% ndaj gjithsej	mijë ton	% ndaj gjithsej
Transport gjithsej	4.201	100,00	6.644	100,00
• Detar	1.355	32,26	4.337	65,27
• Hekurudhor	3	0,08	0	0,00
• Rrugor	2.841	67,62	2.265	34,10
• Ajror	0	0,01	2	0,03
Të tjera	1	0,03	40	0,60

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, INSTAT

TRANSPORTI I PASAGJERËVE SIPAS MËNYRAVE TË TRANSPORTIT, 2023-2025



Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, INSTAT

A E DINI SE?

Gjatë vitit 2025, 94,1 % e volumit të mallrave të transportuara me linja detare është kryer nga porti i Durrësit.
Në vitin 2025, 87,3 % e pasagjerëve udhëtuan nëpërmjet linjave ajrore.

PËRKUFIZIM

Transporti: Lëvizja e pasagjerëve dhe/ose mallrave nga një vendndodhje në tjetrën nëpërmjet hekurudhës, detit, ajrit, infrastrukturës rrugore etj.

35

TURIZMI NË SHQIPËRI




LËVIZJA E SHTETASVE

Në vitin 2025, hyrjet e shtetasve të huaj në Shqipëri janë rreth 12,5 milionë persona ndërsa daljet e shtetasve shqiptarë janë rreth 8,6 milionë persona. Hyrjet e shtetasve të huaj në pikat kufitare, janë rritur me 6,6 % ndërsa daljet e shtetasve shqiptarë janë rritur me 9,0 %, krahasuar me vitin 2024.

Gjatë vitit 2025, hyrjet e shtetasve nga rajoni i Evropës zënë peshën më të madhe të hyrjeve të shtetasve të huaj gjithsej me 95,4 %. Evropa Jugore zë përqindjen më të lartë të hyrjeve të shtetasve të huaj me 75,0 % të hyrjeve gjithsej ndjekur nga Evropa Perëndimore me 10,0 % të hyrjeve gjithsej, Evropa Qendrore/Lindore me 7,3 %, Evropa Veriore me 4,5 % dhe Evropa Lindore/Mesdheut me 3,2 % të hyrjeve gjithsej të shtetasve evropian.

DALJET E SHTETASVE SHQIPTARË DHE HYRJET E SHTETASVE TË HUAJ *(000 / shtetas)*



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, INSTAT

HYRJET E SHTETASVE TË HUAJ SIPAS KOMBËSISË

	2023	2024	2025
Gjithsej	**10.155.640**	**11.696.111**	**12.466.038**
I. Afrika	11.120	31.466	44.736
II. Amerika	240.925	306.116	337.482
III. Azia Lindore dhe Paqësori	66.689	95.991	104.428
IV. Lindja e Mesme	40.446	30.156	34.810
V. Azia e Jugut	15.324	29.845	44.837
VI. Evropa	9.727.538	11.146.979	11.888.574
• Evropa Qëndrore / Lindore	643.332	850.679	867.229
• Evropa Veriore	380.476	491.694	534.624
• Evropa Jugore	7.743.693	8.468.557	8.919.296
• Evropa Perëndimore	744.821	990.143	1.183.377
• Evropa Lindore / Mesdheut	215.216	345.906	384.048
VII. Rajone të paspecifikuara	53.598	55.558	11.171

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, INSTAT

A E DINI SE?

Hyrjet e shtetasve të huaj gjatë vitit 2025 nga Kosova, Italia dhe Maqedonia e Veriut zënë 55,5 % të hyrjeve të shtetasve të huaj gjithsej.

PËRKUFIZIME

Daljet: Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë). Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.
Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë). Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

35

TURIZMI NË SHQIPËRI



STRUKTURAT AKOMODUESE

Gjatë vitit 2025, në vend numërohen 2.364 struktura akomoduese. Numri i strukturave akomoduese është rritur me 12,7 %, krahasuar me 2024. Numri maksimal i dhomave të ofruara është rreth 59 mijë dhoma duke u rritur me 1,6 % dhe numri i shtretërve është rreth 133 mijë shtretër duke u rritur me 1,7 %, krahasuar me 2024.

Gjatë vitit 2025, kohëzgjatja mesatare e qëndrimit të vizitorëve në strukturat akomoduese është 2,3 netë dhe 73,7 % e net qëndrimeve janë realizuar nga vizitorët jo-rezident.

PËRKUFIZIME

Struktura akomoduese: Përfshijnë të gjitha njësitë e akomodimit turistik që ofrojnë një shërbim të paguar akomodimi ose qëndrimi afatshkurtër.

Vizitorë: Përcaktohet si një person i cili qëndron të paktën një natë në hotel ose struktura të ngjashme duke përfshirë edhe fëmijët.

Netë qëndrimi: Është çdo natë që një vizitor rezident ose jo-rezident kalon në një njësi akomodimi.

STRUKTURAT AKOMODUESE ME NUMËR DHOMA DHE SHTRETËR

Përshkrimi i llojit të strukturës akomoduese	Strukturat Akomoduese*			Dhoma			Shtretër		
	2023	2024	2025	2023	2024	2025	2023	2024	2025
Hotele dhe struktura të ngjashme	1.549	1.697	1.811	50.010	50.504	51.573	112.551	113.760	115.649
Akomodime për pushime dhe të tjera akomodime kolektive	239	335	521	6.773	7.000	7.152	14.949	15.235	15.594
Hapësirat për kampingje, për parqe, për çadra ose rulota argëtimi	29	66	32	995	1005	724	2.198	2.217	2.152
Gjithsej	**1.817**	**2.098**	**2.364**	**57.778**	**58.509**	**59.449**	**129.698**	**131.212**	**133.395**

Burimi: Anketa e Strukturave Akomoduese, INSTAT
**Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve*

NETË QËNDRIME DHE KOHËZGJATJA MESATARE E QËNDRIMIT

Përshkrimi	2023	2024	2025
Netë qëndrime	6.007.854	7.445.714	9.688.568
Mesatarja e netëve	2,6	2,3	2,3

Burimi: Anketa e Strukturave Akomoduese, INSTAT

A E DINI SE?

Gjatë vitit 2025, numri më i lartë i vizitorëve rezulton:
- sipas rajoneve, në "Rajonin Qendër" (40,9 %);
- sipas zonave të afërsisë me bregdetin, në "Zonat Bregdetare" (61,6 %);
- sipas llojit të strukturave akomoduese, në "Hotele dhe akomodime të ngjashme" (91,3 %).



35 TURIZMI NË SHQIPËRI

TURIZMI I FAMILJEVE

Në vitin 2024, numri i udhëtimeve për qëllime personale apo biznesi (brenda apo jashtë Shqipërisë) të kryera nga individët banues në Shqipëri të moshës mbi 15 vjeç ishte 4.426.074. Numri mesatar i netëve të qëndrimit për udhëtime të kryera është 4,2 netë. Udhëtimet për qëllime personale përbëjnë 97,9 % të udhëtimeve gjithsej, ndërsa udhëtimet për qëllime biznesi 2,1 % të tyre. Përqendrimet më të larta të udhëtimeve të kryera janë regjistruar në muajt: Gusht (13,9 %), Dhjetor (13,7 %), Korrik (11,5 %) dhe Qershor (9,4 %).

Udhëtimet sipas qëllimit

Në vitin 2024, janë regjistruar rreth 0,6 % më shumë udhëtime në të gjithë Shqipërinë dhe jashtë saj, krahasuar me vitin 2023. Karakteristikë e këtij viti është rritja udhëtimeve të kryera jashtë Shqipërisë me rreth 43,4 % shoqëruar me rritjen e transportit ajror me rreth 8,8 pikë përqindje krahasuar me vitin 2023.

PËRKUFIZIME

Turizmi është veprimtaria e vizitorëve duke ndërmarrë një udhëtim për një destinacion kryesor jashtë vendbanimit të zakonshëm ku jeton, për më pak se një vit, për çfarëdo qëllimi kryesor, duke përfshirë biznesin, kohën e lirë apo qëllime të tjera personale. Personi vizitor nuk duhet të jetë i punësuar nga një subjekt rezident në vendin e vizituar.

Udhëtar do të konsiderohet individi i cili lëviz në vende të ndryshme gjeografike për çdo qëllim dhe kohëzgjatje.

Udhëtimi i referohet veprimtarisë së udhëtarëve.

Udhëtimet sipas destinacioneve


Në vitin 2024, destinacionet më të preferuara për udhëtime për qëllime personale apo biznesi në Shqipëri janë qarqet: Tiranë (15,4 %), Vlorë (12,3 %), Korçë (10,9 %) dhe Durrës (8,6 %).

Në udhëtimet e kryera jashtë Shqipërisë, përqindjet më të larta janë regjistruar në: Itali (8,6 %), Greqi (7,4 %) dhe Gjermani (3,8 %).

A E DINI SE?

Rreth 28,9 % e udhëtimeve si brenda dhe jashtë vendit si vend origjinë kanë qarkun e Tiranës. Nga udhëtimet e kryera gjithsej në vitin 2024, vihet re se përqindjet më të larta për udhëtime me destinacion jashtë Shqipërisë kanë si origjinë qarqet: Tiranë (34,7 %), Durrës (10,8 %) dhe Vlorë (9,3 %).

PËRQINDJA E UDHËTIMEVE SIPAS MUAJIT TË NISJES, 2024



Burimi: Anketa e Turizmit në Familje "Pushime dhe Udhëtime", 2024

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Instituti i Statistikave
Shqipëria në shifra : 2025 / Instituti i Statistikave.
- Tiranë :
INSTAT, 2026.
1 burim në linjë(...f.)

ISBN 9789928390509

1.Statistika 2.Shqipëri
311.312(496.5) "2025"

SHQIPËRIA
NË SHIFRA
2025

INSTAT